

Tiranë, më 17.05.2018

KËRKESË

Per Rivendosjen ne Afat te Apelit kunder Vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqsor
Tirane, Nr.316, date 29.04.2002, ne ngarkim te pandehurit Izet HAXHIA, lene ne fuqi nga
Gjykata e Apelit Tirane, me Vendimin Nr.351, date 09.07.2002.

Baza Ligjore: Nenet 147, 148, 449, 450, 453 e tjere te K.Pr.Penale

Drejtuar: Gjykates se Shkalles se Pare
Tirane

Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tirane, pasi ka gjykuar çeshtjen penale ne ngarkim te pandehurit Izet Haxhia, ne perfundim ka vendosur:

- Te deklaroje fajtor te pandehurin Izet Haxhia, per vepren penale te "Vrasjes me paramendim", kryer ne bashkepunim, te Azem Hajdarit dhe ne baze te Nenet 78/2 dhe 25 te Kodit Penal, e denon ate me 25 vjet burgim.
- Te deklaroje te pafajshem te pandehurin Izet Haxhia per vepren penale te "Vrasjes me paramendim", kryer ne bashkepunim te Besim Çeres, te parashikuar nga Neni 78 dhe 25 te Kodit Penal.

➤ Te deklaroj te pafajshem te pandehurin Izet Haxhia per vepren penale te "Vrasjes me paramendim", kryer ne bashkepunim, mbetur ne tentative te Zenel Nezes, parashikuar nga Neni 78, 25 dhe 22 i Kodit Penal.

➤ Perfundimisht Gjykata e denon te pandehurin Izet Haxhia me 25 vjet burgim.



Ky Vendim i Gjykates per te pandehurin Izet Haxhia, eshte i pabazuar ne dispozitat e Kodit te Procedures Penale, ne Dispozitat Kushtetuese dhe Aktet Nderkombetare. Me konkretisht:

Vertetohet se gjykimi i kesaj ceshtje ne te gjitha shkallet e gjykimit eshte zhvilluar ne mungese te te pandehurit Izet Haxhia dhe pa dijenine e tije. Ai nuk ka leshuar asnje lloj prokure per avokatin qe e ka perfaqesuar ne gjykimin ne Gjykatën e Shkalles se Pare. Ai nuk ka patur dijeni per ankimimin qe i eshte bere vendimit ne Gjykatën e Apelit Tirane, e cila ka lene ne fuqi, Vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare. Vete Izet Haxhia provohet se nuk ka bere deklarime perpara organeve proceduese.

I pandehuri Izet Haxhia, ne vazhdimesi deri me daten 08.05.2018 qe u ekstradua, ka qendruar ne Turqi, nen mbikqyrjen e vazhdueshme te autoriteteve shteterore te ketij vendi.

Vertetohet qe Drejtues te Ministrise se Drejtesise se Republikës se Shqiperise, i kane komunikuar Ministrit te Drejtesise te Turqise, me daten 06.04.2007, garancite e Shtetit Shqiptar ne rigjykimin e Izet Haxhise, ne zbatim te Dispozitave Kushtetuese, te K.Pr.Penale, Nenet 147, 148, 449, 450, 453. Gjithashtu Drejtuesit e Ministrise se Drejtesise kane garantuar respektimin e "Konventes Europiane per Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive Themelore te Njeriut", si dhe te Paktit Nderkombetar te 16 dhjetorit 1966 ne lidhje me te Drejtat Civile dhe Politike. Duke u bazuar ne keto garanci, i pandehuri Izet Haxhia u paraqit prane autoriteteve te policise turke me qellim realizimin e ekstradimit me daten 08.05.2018 ne Rinas, Shqiperi, duke qene i bindur se ai do te degjohet nga Gjykata Shqiptare sepse ceshtja penale ne ngarkim te tije do rigjykohej, meqenese ai ishte gjykuar e denuar ne mungese.

Per t'u realizuar premtimi i Qeverise Shqiptare, se me ekstradimin e Izet Haxhise nga



Turqia ne Shqiperi, çeshtja penale do te rigjykohej, meqenese ishte gjykuar ne mungese, i pandehuri pranoi ekstradimin dhe paraqitit kerkesen per rivendosjen ne afat te ankimit per ne Gjykatën e Apelit. Ne baze te Nenit 450, pika 1, germa "e", "Kur personi eshte gjykuar ne mungese, sipas Nenit 352 te ketij Kodit dhe kerkon rigjykimin e ceshtjes.....kerkesa nuk mund te refuzohet".

Vlen te theksohet se, ne nje Shkrese qe Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes se Shqiperise qe mban daten 15.07.2008, No 10102, drejtuar Gjykates Europiane per te Drejtat e Njeriut, Seksioni i Katert, Strasbourg, firmosur nga Agjente Qeveritare Suela Meneri thuhet se:

Ne pergjigje te letres suaj te dates 20 mars 2008, lidhur me Ankimin Nr.34783/06 "Izet Hashia K. Shqiperise", po ju informoj si vijon:


Shtetasi Izet Haxhia (per me tej ankuesi) eshte gjykuar dhe denuar ne mungese.

Ne pergjigje te pyetjes se pare te Gjykates sa i takon te drejtes se ankuesit per te kerkuar rihapje te proceseve gjyqsore, qe perfunduan me denimin e tije, ne kushtet kur procesi per ekstradimin e ankuesit nga Turqia eshte ende pezull sqarojme se, edhe ne rastin konkret ashtu sikurse ndodh zakonisht ne praktiken vendase te ekstradimeve, Shteti Shqiptar nder te tjera i ka ofruar Shtetit Turk garanci (dokumenti bashkelidhur), per respektimin e te drejtes se ankuesit per t'u rigjykuar konforme Kushtetutes se Republikes se Shqiperise dhe Neneve 147, 148, 449, 450, 453 te Kodit te Procedures Penale (Legjislacioni relevant bashkelidhur).

Ne keto rrethana ne baze te dispozitave ligjore qe cituam me larte:

Kerkojme

Pranimin e Kerkeses per Rivendosjen ne Afat te se Drejtes se Ankimit per ne Gjykatën e Apelit Tirane, ku do paraqesim te gjithë pretendimet tona ligjore, lidhur me Vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane Nr.316, date 29.04.2002, ne ngarkim te pandehurit Izet Haxhia, lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Tirane me Vendimin Nr.351, date 09.07.2002.




Kerkuesi

Izet Haxhia

IZET HAXHIAJ

Adresa:



Avokat Bashkim Nikolla

Rruga "Myslym Shyri"

Pall.51, Ap.4, Tirane

Tel. 0696502275

0693557213

Avokat

Bashkim Nikolla



Izet Haxhia

I.E.V.Penale

Rruga "Mine Peza"

Tirane